



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 211 prot.

Tiranë, më 06. 02. 2023

V E N D I M

Nr. 20, datë 06. 02. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa me nr. 167, datë 07.11.2022, e R. J., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes shëndetësore”, nga ana e KMCAP Tiranë¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se ankuesja R. J. është nëna e një djali 3-vjeçar², D. J., i cili është diagnostikuar me status post infeksioni kongenital CMV Encephalopathia dhe ka një prapambetje psikomotore të rëndë. Referuar aktit “Fletëdrejtimi për Komision Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP)” rezulton se fëmija reagon, por nuk orientohet konform moshës, nuk flet, nuk ecën, duket i zbehtë, ka mikrocefali dhe dismorfia faciale, hypotonik të gjeneralizuar, kriza konvulsive toniko-klonike etj. Fëmija trajtohet me mjekim të posaçëm dhe me kemp që prej datës 01.06.2021. Nëna e fëmijës shprehet se ka aplikuar dy herë pranë KMCAP Tiranë, për të përfituar pagesën e kujdestarisë, por i janë refuzuar kërkesat. R. J. shprehet se fëmija ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme, fakt që evidentohet edhe në diagnozën e tij, ndërkohë që edhe mosha e tij vogël e shton përgjegjësinë dhe rëndësinë e kujdesit të nënës. Ajo sqaron se nuk mund ta çojë në kopësht, pasi prapambetja e tij mendore është e tillë që kërkon vetëm përkujdesjen e saj të vazhdueshme.

¹ Shkurtesë e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Tiranë

² Referuar certifikatës personale të datës 24.08.2022, rezulton se D. J. është i datëlindjes 18.06.2019;

Me vendimin nr. 3240, datë 28.06.2022, KMCAP Tiranë ka vendosur që D. J. është person me aftësi të kufizuar i grupit të dytë, që prej datës 01.06.2022 deri në datën 01.06.2023. Në këtë vendim është vlerësuar se fëmija nuk ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër. Kjo vendimmarrje e KMCAP Tiranë kundërshtohet nga nëna e D. J., e cila thekson faktin se djali i saj është në gjendje të rëndë dhe se përkujdesja e saj, e vazhdueshme është e nevojshme dhe e domosdoshme për të.

Në këto kushte, ankuesja pretendon se fëmija i saj diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes së tij shëndetësore nga ana KMCAP Tiranë, si dhe kërkon trajtimin e tij me pagesë kujdestarie.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 167, datë 07.11.2022, të bërë nga R. J., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1451/1 prot., datë 17.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, KMCAP Tiranë, i ngritur pranë Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e bërë nga R. J.

Në përgjigje sa më sipër, Shërbimi Social Shtetëror, me shkresën³ nr. 2427/1 prot., datë 24.11.2022, informoi ndër të tjera se: “...*Diagnoza-Gjendje post infeksioni kongenital CMV, Epilepsi e gjeneralizuar, Encefalopati, Prapambetje psiko-motore e përshkruar në Fletën e Drejtimit për Kemp, lëshuar nga Shërbimi i Pediatriisë së Specialiteteve më datë 14.04.2022, nuk është në kushtet e përfitimit të grupit të parë. Sipas Urdhërit nr. 362, datë 26.02.2007, Kreu VI dhe XI, përfitojnë grupin e parë Encefalopatitë e rënda dhe Prapambetja mendore e thellë.*

KMCAP-i i Nivelit të Parë Neurologji-N/Kirurgji i mbledhur më datë 28.06.2022 dhe me vendim nr. 3240, e ka vlerësuar D. J. përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar grupi i dytë. Ky vlerësim është bërë duke shqyrtuar dokumentacionin mjekësor që ndodhej në dosje, komunikimin online sipas Urdhërit nr. 577, datë 14.10.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe kriterëve mjekësore sipas Urdhërit nr. 362, datë 26.02.2007 “Për miratimin e rregullores për kriteret mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar”. Vendimi i KMCAP-it të nivelit të parë është i ankimueshëm, ankesë të cilën R. J. e ka bërë dhe është protokolluar më datë 06.10.2022. Bazuar në VKM-në nr. 182/2020 të ndryshuar, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1451/2 prot., datë 30.11.2022

me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal”, Shërbimi Social Shtetëror do të njoftojë zyrtarisht D. J. për tu paraqitur në muajin dhjetor në KMCAP-in Epror”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 49 prot., datë 10.01.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Më datë 26.01.2023, ankuesja ka paraqitur pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë, një shkresë⁴ duke kërkuar pushimin e ankesës, për përfitimin e pagesës së kujdestarisë për djalë e saj, pasi problemi i saj i bërë objekt i ankesës është zgjidhur falë ndërmjetësimit të strukturave të Komisionerit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa"*, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *"Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ"*.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, i cili parashikon se: *"Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë"*, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"*, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁴ Përcjell me e-mail datë 30.01.2023, nga ana e përfaqësueses pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 167, datë 07.11.2022, të R. J., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)